



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	20.12.2021	viti god year	1
Organ / Njësia Org. Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6239/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.923/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj - Demi dhe Arben Mehmeti- anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.886/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën A.nr.70/2020, të datës 05.03.2020, të parashtruar nga ankuesit

Avokati dhe Avokati të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë Rr. "A.Zhitia" p/n, Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Universitetit të Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 20.12.2021, mori këtë

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.70/2020, e datës 05.03.2020, e parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokati dhe

A r s y e t i m

Ankuesit

dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokati dhe Avokati më datë 05.03.2020 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 597/2020 të regjistruar me numër A.nr.70/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shpërblimit jubilar të ankuesve, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Nr.013/2056 të datës 18.04.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, me datë 11.03.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesve nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Këshilli më datë 15.10.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.886/2020 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e parashtruar me datë 05.03.2020 nga ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 597/2020 të regjistruar me numër A.nr.70/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 27.11.2019; Kërkesën e datës 03.01.2019 (pa protokoll pranimit), drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave dhe Këshillit Drejtues të UP-së; Përgjigjen në ankesë të datës 15.10.2020, me numër protokoll 2103/2020, me shkresat e bashkangjitura (Akt Emërimit).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës një nga një dhe të gjitha se bashku ka konstatuar se ankesa A.nr.70/2020 e datës 05.03.2020 është e pa lejuar sepse:

Bazuar në provat e lëndës, rezulton se ankuesit janë të punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe të njëjtit me datë 05.03.2020 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e shpërblimit jubilar sipas viteve të përvojës se punës, bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, Nr.013/2056 të datës 18.04.2017.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve, ka parashtruar ankesën me numër A.nr.70/2020 të datës 05.03.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa i shteruar mjete e brendshme në organin e punësimit, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 81 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, dhe dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 16 paragrafi 4 ku përcaktohet se: Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.*



Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve, se bashku me shkresat e lëndës ka sjellë si prove kërkesën e datës 23.01.2020, përmes të cilës pretendon se i është drejtuar Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", mirëpo nga shkresa e njëjtë nuk mund të provohet se kërkesa në fjalë është pranuar ndonjëherë nga këto organe të Universitetit të Prishtinës. Pra, kërkesa e përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, drejtuar këtyre organeve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" mban vetëm datën dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, por jo edhe ndonjë dëshmi se e njëjta është pranuar nga organet përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Andaj, në mungesë të provave me shkrim, përmes të cilave dëshmohet se organi i punësimit ka pranuar kërkesën e ankuesve, Kolegji vlerëson se nuk mund të shqyrtohet ankesa për shkak të heshtjes administrative dhe të pranohet pretendimi ankimor. Rrjedhimisht, Kolegji konstaton se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmeri të ankesës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.923/2021


Rushit Kajtazi
Procesmbajtës


Jeton KOCA
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, Avokatit dhe
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në UP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

